

CRNA GORA

Opština Tuzi

Br.Nr:01-031/20-4416

Tuzi- Tuz, 19.05.2020.godine

MALI I ZI  
Komuna e Tuzit

**SKUPŠTINA OPŠTINE TUZI**  
**n/r g-dinu Fadil Kajoshaj – predsjedniku**

**PREDMET:** Dostava Predloga Odluke

**NAPOMENA:** Uvrstiti u dnevni red naredne sjednice Skupštine Opštine

**PODNOŠILAC PREDMETA:** Predsjednik Opštine

**PRILOG:** Predlog Odluke sa obrazloženjem

Poštovani,

Na osnovu člana 60 stav 2 Statuta opštine Tuzi („Službeni list CG-opštinski propisi“ br. 24/19, 05/20) u prilogu Vam dostavljam:

- Odluku o mjerama za ublažavanje finansijskih posledica nastalih usled pandemije COVID-19 u opštini Tuzi.

Za predstavnika predlagača koji će učestvovati u radu Skupštine i njenih radnih tijela prilikom razmatranja ovog materijala određuje se Emin Haxhi VD sekretara Sekretarijata za finansije i ekonomski razvoj.

**KUVENDIT TË KOMUNËS SË TUZIT**  
**Z. Fadil Kajoshaj - Kryetar**

**LËNDA:** Dorëzimi i Propozim Vendimit

**VËREJTJE:** Të përfshihet në rendin e ditës në seancën e rrallës së Kuvendit të Komunës

**PARASHTRUESI I PROPOZIMIT:** Kryetari i Komunës

**SHTOJCË:** Propozimi i Vendimit me arsytim

I nderuar,

Në bazë të nenit 60 paragrafit 2 të Statutit të komunës së Tuzit (“Fleta zyrtare e MZ- dispozitat e komunës” nr. 24/19, 05/20) bashkëngjitur Ju dorëzoj:

- Vendimin mbi masat për zbutjen e pasojave financiare të krijuara në Komunën e Tuzit për shkak të pandemisë së COVID-19

Për përfaqësues të propozuesit i cili do të marrë pjesë në punën e Kuvendit dhe trupave punues të tij gjatë shqyrtimit të këtij materiali, përcaktohet Emin Haxhi, UD së sekretarit të Sekretariatit për financa dhe zhvillim ekonomik.

S poštovanjem,  
Me respekt,

**PREDSJEDNIK – KRYETARI,**  
Fadil Gjelošhaj



Në bazë të nenit 38 paragrafit 1 pikës 2 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 2/18, 34/19, 38/20), e në lidhje me nenin 25 paragrafi 1 pika 12 e Statutit të Komunës së Tuzit lokale ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 24/19, 05/20), Kuvendi i komunës së Tuzit, në seancën e mbajtur më \_\_\_\_\_, 2020 ka sjellë

## **VENDIM**

### **mbi masat për zbutjen e pasojave financiare të krijuara në Komunën e Tuzit për shkak të pandemisë së COVID-19**

#### **Neni 1**

Me këtë Vendim përcaktohen masat të cilat kanë për qëllim të zbusin pasojat financiare në Komunën e Tuzit të dala për shkak të COVID-19.

#### **Neni 2**

Sekretariati për financa dhe zhvillim ekonomik është i obliguar të përcjellë realizimin e të ardhurave mujore dhe të harmonizojë ekzekutimin e shpenzimeve sipas përparësive të përcaktuara në përputhje me fondet në dispozicion, përkatësisht përqindjen e realizimit të buxhetit për të ruajtur bilancin e buxhetit.

#### **Neni 3**

Të gjitha njësitë e shpenzimeve janë të detyruara t'i mbajnë në minimum shpenzimet, si dhe të mos krijojnë detyrime të reja financiare të cilat janë të panevojshme.

#### **Neni 4**

Me qëllim të përkrahjes së bujqësisë në territorin e Komunës së Tuzit, të ndahen 100.000,00 euro shtesë, për program për magazinimin e tepricave të prodhimeve bujqësore.

#### **Neni 5**

Administrata e të ardhurave lokale publike e Komunës së Tuzit do të:

- 1) Lirojë të gjithë personat fizik nga tatimi në truall për vitin 2020, çka nënkupton që nuk do të bëhet dorëzimi i aktvendimeve mbi tatimin e caktuar në truall për vitin 2020 për personat fizik;
- 2) Shtyjë pagesën e mbitatimit në tatim mbi të ardhurat personale për një periudhë 4 muaj (me kërkesë të tatimpaguesit);
- 3) Shtyhet pagesa e tatimit në patundshmëri për këstin e parë prej më 31.08.2020, e për të dytin deri më 30.11.2020 (me kërkesë të tatimpaguesit);
- 4) Lirojë nga pagesa e kompensimit mujor për pajisje komunale të truallit ndërtimor të gjithë investitorët që kanë lidhur kontrata për pagesa në këste mujore për periudhën 3 mujore (me

kërkesë të tatimpaguesit). Për periudhën e cekur nuk do të përlogaritet kamata për mospagimin e obligimeve të arritura;

- 5) Lirojë nga pagesa e kompensimit për përdorimin e objekteve tregtare, të cilave u sigurohet qasje nga rruga komunale për një periudhë 4 muaj;
- 6) Pezullojë të gjitha masat e pagesës së detyrueshme në afat prej 4 muajsh;
- 7) Lirojë nga pagesa e taksës lokale komunale të përcaktuar në bazë të nxënies së sipërfaqes (kopshte veror, kopsht i mbyllur dhe objekte të tjerë lëvizëse) për periudhën 4 mujore;
- 8) Lirojë nga pagesa e kontributit të anëtarësimit në organizatën turistike për një periudhë 4 mujore.

#### **Neni 6**

Ky vendim hynë në fuqi me ditën e publikimit në “Fletën Zyrtare të Malit të Zi – dispozitat komunale”.

Nr.01-031/20-  
Tuz, \_\_\_\_\_ 2020.

**KUVENDI I KOMUNËS SË TUZIT**  
**Kryetari,**  
**Fadil Kajoshaj**

## ARSYETIM

### BAZA LIGJORE

Neni 38, paragrafi 1 pika 2 e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 2/18, 34/19, 38/20), është caktuar se Kuvendi sjellë rregullore dhe akte të tjera të përgjithshme deri sa me nenin 25 paragrafin 1 pika 12 e Statutit të komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 24/19, 05/20) përcakton se Komuna e Tuzit kryen edhe punë të tjera në pajtim me nevojat dhe interesat e banorëve të Komunës së Tuzit.

### ARSYET PËR SJELLJEN E VENDIMIT

Për shkak të rrethanave të shkaktuara nga pandemia e COVID-19, Qeveria e Malit të Zi nxori një seri masash dhe porosish të cilat, për të parandaluar futjen e sëmundjeve infektive në vend, eliminoj dhe parandalojnë transmetimin në vendet e tjera, si dhe mbrojnë popullsinë nga korona virusi i ri, mes të tjerave ka ndaluar punën për numrin më të madh të objekteve tregtare; është kryer pezullimi i transportit taksi; ndaluar ofrimi i shërbimeve hoteliereje; palestra, parukierë dhe sallone bukurie; transporti publik i udhëtarëve në periferinë dhe autobusët e qytetit dhe transporti me fugon është pezulluar. Duke pasur parasysh ato më sipër, një numër i caktuar i subjekteve afariste janë të ndaluar të kryejnë veprimtarinë e tyre dhe të gjenerojnë të ardhura.

Në mënyrë që të zbuten dhe minimizohen efektet negative financiare të shkaktuara nga pandemia e COVID 19, lehtësimi të jetës së qytetarëve dhe ndihmës ndaj bizneseve, dhe duke pasur parasysh edhe rekomandimet e Qeverisë së Malit të Zi, me masat e përfshira në këtë vendim është dhënë mbështetja ndaj qytetarëve dhe bizneseve.

Duke marrë parasysh që Urdhri për marrjen e masave të përkohshme për të parandaluar futjen në vend, eliminimin dhe parandalimin e transmetimit të korona virusit të ri ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 023/20, datë 25.03.2020) ndalon qytetarët e Komunës së Tuzit që të lënë banesa dhe të lënë territorin për Komunën e Tuzit, dhe që për shkak të situatës së re për shkak të pandemisë korona virus në Mal të Zi, seancat e Kuvendit nuk mund të mbahen deri në njoftimin e mëtutjeshëm, Kryetari i Komunës, në përputhje me kompetencat e përcaktuara me nenin 59 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, sjelli këtë Vendim.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij, dhe do të botohet në "Fletën Zyrtare të Malit të Zi - dispozitat komunale".

Vendimi i paraqitet Kuvendit për konfirmim në seancën e parë të radhës.